

KONTRATË SHITBLERJE

(KUOTASH)

Në Tiranë, sot më datë 31/01/2022 palët e mëposhtme kontraktuese lidhin këtë kontratë shitblerje kuotash:

Shitësi: z. **Erigent Kallollari**, shtetas shqiptar, lindur më 03.03.1990 dhe banuese në Tiranë, identifikuar me Letërnjoftimin ID me Nr. **037035704**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (referuar me poshtë si **Shitësi**)

Blerësi: znj. **Rosa Paoella** shtetase italiane, lindur ne Itali me 03.07.1970 me Leternjoftim ID me nr YA6250872, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (referuar më poshtë si **Blerësi**)

Të përgjithshme

- A. Shoqëria "R.E.I HOLDING" sh.p.k, është person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Nr. NUIS **L91325017M**. Kapitali i shoqërisë "R.E.I HOLDING" SHPK është 70.000,00 (shtatedhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 1 (nje) kuotë.
- B. Shitësi është ortak i Shoqërisë "R.E.I HOLDING" SHPK (100 përqind) dhe zotëron një kuotë në Kapitalin e Shoqërisë me pjesmarrje në përqindje 100 %

Rosa Paoella
@



- C. Në përputhje me nenin 73: “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave” pika 1/b dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare», neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe në Statutin të Shoqërisë “R.E.I HOLDING”sh.p.k, Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Objekti

- A. 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja e $\frac{1}{2}$ te kesaj kuote, që Shitësi zotëron në kapitalin themeltar, e cila përfaqëson 50 % (pesedhete përqind) të Kapitalit të Shoqërisë. Kjo kuotë transferohet nga Shitësi në pronësi të Blerësit i cili mbas shitjes se kesaj kuote do te zoteroje 50% te kapitalit te shoqerise.
- 1.2 Blerësi pranon pronësinë e kesaj kuote e cila perfaqeson 50 % (pesedhete përqind) të Kapitalit të Shoqërisë dhe pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi për blerjen e kuotës do të jetë kundrejt vlerës nominale të saj, në total i barabartë me 35.000,00 (tridhjet e pese mijë) Lekë. Kjo shumë është likujduar totalisht në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.



Neni 3

Garancitë

3.1 Shitësi është pronari i ligjshëm i 100 % të kuotës në shoqërinë “R.E.I HOLDING” sh.p.k, rrjedhimisht edhe i pjeses që kalon në pronësi të blerësit.

Shitësi garanton Blerësin që 50 % të kuotës së transferuar është krejtësisht e lirë dhe nuk është vendosur si mjet ligjor për të siguruar ekzekutimin e ndonjë detyrimi.

Neni 4

Regjistrimi

4.1. Regjistrimi i transferimit të kuotës në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit është kryer në bazë të nenit 74 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » si dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm

5.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe Statuti i Shoqërisë “R.E.I HOLDING” sh.p.k.

Neni 6

Juridiksioni

- 6.1. Për çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 7

Të ndryshme

- 7.1. Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
- 7.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.
- 7.3. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, duke respektuar formën shkresore.

Kjo kontrate u përpilua në 3 kopje me vlerë të barabartë ligjore. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët.




Shitësi



Erigent Kallollari

Blerësi



Rosa Paoella